



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2433 Prot.

Tiranë, më 27.04. 2020

U R D H Ë R

Nr. 103, datë 27.04.2020

P Ë R

**MARRJEN E MASAVE PËR MBYLLJEN E VITIT SHKOLLOR 2019-2020
NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR,
PËR SHKAK TË GJËNDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE
TË SHKAKTUAR NGA PANDEMIA E COVID-19**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të vendimit nr. 18/2020, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” dhe të pikës 6.1 të vendimit nr. 243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”,

U R D H Ë R O J:

1. Qendrën e Shërbimeve Arsimore, Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtorië e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar, për mbylljen e vitit shkollor 2019-2020, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e COVID-19, të marrin masa për:
 - a) për kthimin në klasë të nxënësve maturanë, për vijuar mësimin nga data 18 maj deri më 5 qershor 2020, duke respektuar rregullat e përcaktuara në rregulloret përkatëse, si dhe duke zhvilluar vetëm lëndët e provimeve të detyruara të Maturës Shtetërore: gjuhë shqipe dhe letërsi, matematikë, gjuhë e huaj e parë, si dhe lëndën që kanë zgjedhur në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore. Gjatë kësaj periudhe do të zhvillohet vetëm përsëritje bazuar në programet orientuese të rishikuara, ku janë hequr të gjitha njohuritë e zhvilluara pas datës 9 mars, gjatë mësimin në kushtet e shtëpisë;

- b) për krijimin e kushteve për maturanët për dhënien e provimeve të Maturës Shtetërore (MSh) në periudhën 8 deri më 18 qershor, duke respektuar rregulloren e rishikuar të MSh-së;
 - c) për miratimin e rregulloreve të brendshme nga të gjitha institucionet arsimore për sjelljen e nxënësve maturanë në shkollë, hyrje-daljet, mbrojtjen e tyre, distancimin fizik, lëvizjet, si dhe higjienizimin dhe dezinfektimin e rregullt të ambienteve, në përputhje me rregulloren e miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe me rekomandimet e Institutit të Shëndetit Publik;
 - d) për vijimin e mësimit në kushte shtëpie për të gjithë nxënësit e klasave 1-11, deri në mbylljen e vitit mësimor më 29 maj 2020, bazuar në planin mësimor dhe në orarin mësimor të hartuar nga secila shkollë për lëndët dhe klasat përkatëse;
 - e) për kryerjen e vlerësimit në lëndët e provimeve kombëtare për nxënësit e klasës së 9-të, sipas udhëzimit përkatës;
 - f) për përmbylljen e punës me dokumentacionin shkollor nga të gjithë mësuesit deri më 18 qershor 2020.
2. Të gjitha institucionet e arsimit të mesëm të larë të hartojnë dhe të paraqesin në ZVA-të përkatëse, brenda datës 8 maj 2020, planin e masave organizative dhe administrative, sipas përcaktimeve të këtij Urdhri, në të cilin të përfshijnë, numrin e saktë të nxënësve maturanë që do të frekuentojnë shkollën, sipërfaqet në dispozicion të shprehur në m², me qëllim garantimin e distancimit fizik të nxënësve dhe të mësuesve.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Besa SHAHINI

